



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:113994

Datë: 13.06.2024

Numri i dokumentit: 05872978

Ac.nr.1123/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Dardan Kadolli, kryetar i kolegjit, Hunaida Pasuli dhe Nehat Idrizi, anëtar të kolegjit, në çështjen kontestimore të paditësit duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditësit F. H. nga Gj. , përfaqësuar nga F. S. – avokat nga Gjilani, me adresë Rr.” B. i P.” H-3..., K-..., nr.. , Gjilan, kundër të paditurit Spitali i Përgjithshëm “Isa Grezda” Gjakovë, rruga “Dëshmorët e Lirisë”, në çështjen juridike kontest pune pagesë e shpërblimeve jubilarë, vlera e kontestit 3,708.30 euro, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.794/2021, i datës 15.12.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 13.06.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurës Spitali i përgjithshëm “Isa Grezda”, me seli në Gjakovë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.794/2021, datë 15.12.2021, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar C.nr.794/2021, i datës 15.12.2021, ka vendosur: **APROVOHET** kërkesëpadia e paditësit F. H. nga Gjakova dhe **DETYROHET** i padituri Spitali i Përgjithshëm “Isa Grezda” në Gjakovë, që paditësit në emër të shpërblimit jubilar për 30 vite të përvojës së punës, t’ia paguaj në emër të tri pagave shumë prej 3,708.30 euro (tre mijë e shtatëqind e tetë euro e tridhjetë cent), me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të llogaritet nga data 01 dhjetor 2021, e gjer në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 279.00euro (dyqind e shtatëdhjetë e nëntë euro), të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor, ankesë ka paraqitur pala e paditur, për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit të Kosovës ta aprovojë ankesën si të bazuar ndërsa aktgjykimin e ankimuar ta hudh poshtë.

Pala paditëse ka parashtruar përgjigje në ankesë përmes së cilës i ka kundërshtuar pretendimet ankimore të të paditurës si të pabazuara, me propozim që ankesa e të njëjtës të refuzohet si e pabazuar ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet si dhe të detyrohet paditura që paditësit t'ia kompensojë shumën prej 104,00 € në emër të përpilimit të përgjigjes në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

- Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi F. H. nga Gj., me datë 09.06.2021, përmes të autorizuarit të tij, ka parashtruar padi në gjykatën e shkallës së parë, për kompensimin e shpërblimit jubilar, me pretendimet se i njëjti është në marrëdhënie pune tek e paditura si shef i Traktit Operativ ne Dhomen e Zgjimit të SP “Isa Grezda” dhe ka mbi 30 vite përvojë pune dhe se në bazë të Kontratës Kolektive Sektoriale të njëjtit i takon kompensimi nga e paditura, në vlerë të tre pagave mujore në shumë prej 3708.10€, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Pala e paditur ka paraqitur përgjigje në padi përmes së cilës i ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e paditësit dhe ka kërkuar nga gjykata që ta refuzoj në tërësi padinë e paditësit, si të pabazuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, ka mbajtur shqyrtimin kryesor dhe pas administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.794/2021, të datës 15.12.2021, me të cilin e ka aprovuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetimin e aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se me kontratën e punës datë 07 shkurt 2020, është provuar rrethana se paditësi ka lidhur kontratë pune me të paditurin, me detyrat e punës: Ushtrues detyre - Shef i Traktit Operativ me Dhomën e Zgjimit, me kohëzgjatje të kontratës 07.02.2020 deri në shpallje të konkursit. Nga Vërtetimi i marrëdhënies së punës të datës 31 maj 2021, vërtetohet rrethana se këtu paditësi, i punësuar tek i padituri si Ushtrues detyre – Shef i Traktit Operativ në Dhomën e Zgjimit, ka filluar punën nga data 25 qershor 2007 e tutje dhe sipas shënimeve të dosjes së personelit ka 30 vite përvojë pune. Nga lista e pagave e lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, e cila i referohet muajit prill 2021 vërteton rrethanën se paditësi ka përvojë pune 30 vite dhe realizon pagë neto mujore në lartësi prej 1236.10€. Nga provat e administruara si më lartë, gjykata gjeti se paditësi është i punësuar tek i padituri për më shumë se 30 vite, e prej kohës kur i ka mbushur 30 vite përvojë pune, paditësit nuk i është bërë pagesa për shpërblim jubilar në vlerë të tri pagave mujore, të

parapara me nenin 17 paragrafi 3 pika 3.3 të Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë (KKS). Mos pagesën e pagave edhe përgjatë shqyrtimit gjyqësor e pohoi e autorizuar e të paditurit, se pagesa nuk i është bërë pasi që Qeveria e Republikës së Kosovës gjegjësisht Ministria e Financave nuk ka vijë buxhetore për këtë kategori.

Për mënyrën e vendosjes, gjykata e shkallës së parë i është referuar dispozitave ligjore nga neni 17, paragrafi 3, pika 3.1 dhe 3.3 të Kontratës Kolektive Sektoriale e lidhur me nenin 245 të LMD-së dhe 55, paragrafi 2 të Ligjit të Punës. Vendimin mbi shpenzimet e procedurës e ka mbështetur në dispozitën nga neni 449 dhe 452, paragrafi 1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit e aprovon në tërësi vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, dhe as në shkeljet nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe rrjedhimisht nuk ka aplikim të gabuar të drejtës materiale për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së. Nuk kishte pretendim ankimor specifik për sa i përket shkeljeve të dispozitave procedurale, prandaj gjykata kufizohet në vetëm ato që kujdeset sipas detyrës zyrtare. Po ashtu edhe për shkakun ankimor që lidhet me gjendjen faktike, nuk është ankuar e paditura.

Është vlerësim i kësaj gjykate, se gjykata e shkallës së parë drejtë ka aplikuar edhe të drejtën materiale, kjo për arsye se me nenin 90 paragraf 1 të Ligjit të Punës 03/L-212 të datës 01.11.2010, përcaktohet se “Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në mes: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve. Me paragrafin 1 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive mund të lidhet a) të nivel të vendit, b) në nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes. Me paragrafin 3 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në gjuhën zyrtare të Republikës së Kosovës. Me paragrafin 4 përcaktohet se Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive”.

Me nenin 17 parag.3, të Kontratës Kolektive Sektoriale, e cila ka hyrë në fuqi me datën 11.06.2018, përcaktohet se “*Punëtorët shëndetësor, në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit në vlerë: 3.1. Për 10 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, në vlerë të një page mujore të tij; 3.2. Për 20 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, në vlerë të dy paga mujore të tij; 3.3. Për 30 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, te punëdhënësi i fundit në vlerë të tri paga mujore të tij*”. Me nenin 17 parag.4 të kësaj Marrëveshje përcaktohet se: “*Punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblime jubilarë. Shpërblimi jubilar, paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf*”. Ndërsa paditësi plotësimit të kushtit të tridhjetë viteve përvojë pune e ka arritur, që është vërtetuar përmes listës së pagave, nga mund të vërtetohet e njëjta përvojë, dhe mbi këtë bazë kërkesëpadia është e bazuar. Andaj mbi bazën e të lartcekurave, kjo gjykatë gjeti se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar, për çka edhe vendosi që të njëjtin ta vërtetoj sikurse në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Pretendimi i të paditurës për mungesë të linjës së veçantë buxhetore është i pabazuar, ngase e paditura si organ përgjegjës për punëtorët e saj, është obliguar që ta zbatojë këtë kontratë kolektive dhe me kohë të planifikojë buxhetin, andaj meqenëse paditësi ka qenë dhe është në marrëdhënie pune tek këtu e paditura më shumë se 30 vite, atëherë përgjegjësia për pagimin e shpërblimit jubilar bie mbi të paditurën.

Nga arsyet e lartcekura, Gjykata e Apelit e aprovon në tërësi arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë sa i përket vendosjes lidhur me aprovimin e kërkesëpadisë së paditësit që në emër të shpërblimit të pagës jubilarë t'ia kompensojë shumën e aprovuar si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar. Gjithashtu edhe për lartësinë e kërkesëpadisë gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejtë dhe në mënyrë të ligjshme, pasi që në shkresat e lëndës ka pasur prova të mjaftueshme siç është lista e pagave dhe vërtetimi për përvojën e punës, nga të cilat edhe është vërtetuar saktësisht lartësia e kërkesëpadisë, andaj dhe u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në këtë drejtim edhe vendimi për shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozitat e LPK-së, dhe sa i përket lartësisë është në harmoni me tarifën e Odes së Avokatëve dhe tarifat për shpenzime gjyqësore. E drejta material, përkatësisht neni 382 par.1 dhe 2 i LMD-së, është zbatuar në mënyrë të drejtë edhe sa i përket kërkesës aksesore përkitazi me kamatën.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 par. 1 pika d) të LPK-së, lidhur me neni 200 të LPK-së, u vendosë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL
Ac.nr.1123/2022, datë 13.06.2024

Kryetari i Kolegjit, Gjyqtari
Dardan Kadolli